



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.2652, datë 17.12.2015

Miratimin e dokumentit “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”-dokument përfundimtar.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1.	Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2.	Z. Alban	Karapici	Anëtar
3.	Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4.	Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5.	Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 17.12.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e dokumentit “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar” dokument përfundimtar.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr 8485 datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative” i ndryshuar;
2. Ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” Neni 9 pika 13 dhe 14, Neni 37, 55 dhe neni 56 ;

3. Urdhër nr. Nr.1525 datë 7.09.2015 Nr.prot.1633 datë 7.09.2015
4. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Relacion për dokumentin “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”- document përfundimtar;
2. Dokumenti “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”;
3. Projektvendimi përkatës, si dhe diskutimeve në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N s e :

1. Grupi i punës i ngritur me Urdhër të Titullarit nr. Nr.1525 datë 7.09.2015 Nr.prot.1633 datë 7.09.2015, bazuar në Nenin 9 pika 13 dhe 14, Neni 37, 55 dhe 56 të Ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, përgatiti dokumentin “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”.
2. AKEP me Vendim të Këshillit Drejtues nr.2630 datë 29.10.2015, miratoi nxjerrjen e dokumentit për këshillim publik “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar”. Dokumenti u publikua në faqen e internetit të AKEP dhe këshillimi publik u krye për periudhën 03.11.2015 deri më 02.12.2015.
Gjatë afatit ligjor të parashikuar për realizimin e Procesit të Këshillimit Publik, rezulton se nuk janë depozituar komente apo mendime nga palët e interesuara.
3. Dokumenti përfundimtar i përgatitur pas këshillimit publik synon të plotesojë kuadrin nënligjor dhe përmban përcaktime në lidhje me: procedura, afate dhe rregulla për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe mosmarrëveshjet ndërmjet ofruesve të shërbimit postar, duke pasur në vëmendje

përbushjen e objektivave rregullatorë për nxitjen e konkurrencës dhe mbrojtjen e interesave të përdoruesve.

4. Nëpërmjet dokumentit “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve të shërbimit postar, synohet të arrihet qëllimi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nga AKEP, në mënyrë transparente, të shpejtë, objektive dhe jodiskriminuese.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në sa më sipër, në kompetencat që i janë dhënë nga Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative” i ndryshuar, Ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji Nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative” i ndryshuar;

VENDOS:

1. Miratimin e dokumentit “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar” – dokument përfundimtar.
2. Ky Vendim dhe dokumenti “Rregullore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet përdoruesit dhe ofruesit të shërbimit postar si dhe ndërmjet ofruesve të shërbimit postar” –dokument përfundimtar, të publikohet në faqen elektronike të AKEP www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____

